



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:123806

Datë: 29.07.2024

Numri i dokumentit: 05992942

KPPP.nr.736/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “IP Group” SH.P.K., me NUI: 811496729, me seli në Suharekë, fshati Shirokë Magjistranja Suharekë - Prizren, përfaqësuar sipas autorizimit nga Besnik Kuçi, avokat nga Suhareka, kundër debitorit “A & O Group” SH.P.K., me NUI: 811550856, me seli në Prishtinë, rruga “Muharrem Fejza” Hy.1/14-1, duke vendosur lidhur me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme si dhe prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.100/2024 të datës 29.01.2024, të Përbaruesit Privat Liridon H. Tërshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 29.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme dhe prapësimi i debitorit “A & O Group” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.100/2024 të datës 29.01.2024, të Përbaruesit Privat Liridon H. Tërshani.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “IP Group” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.100/2024 të datës 29.01.2024, me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.1408 të datës 01.11.2023, Faturës Nr.1455 të datës 03.11.2023, Faturës Nr.1470 të datës 06.11.2023, Faturës Nr.1524 të datës 15.11.2023, Faturës Nr.1587 të datës 24.11.2023 dhe Faturës Nr.1614 të datës 30.11.2023, me

të cilin ka detyruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 26,783.22 €, me kamat ligjore 8% ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, deri në pagesën e shumës së kërkuar për përmbartim duke llogaritur edhe kamatën nga dita e pranimit të urdhrin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi.

Debitori në kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme ka theksuar se bllokimi i llogarive është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore për faktin se debitori nuk është njoftuar për propozimin dhe urdhrin përmbartimor. Nga fletëkthesa në shkresat e lëndës vërtetohet se i njëjti nuk e ka pranuar urdhrin përmbartimor pasi që adresa ka qenë jo e plotë, ndërsa sa i përket dërgimit të urdhrin përmes email-it e njëjta nuk ka dëshmi se është pranuar nga ana e debitorit. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, të lejoj kthimin në gjendjen e mëparshme si dhe të obligohet përmbartuesi privat të bie urdhër për lirim e llogarive të debitorit.

Debitori kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme ja ka bashkangjitur edhe prapësimin me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbartimore nuk i plotësojnë kushtet sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, pasi që në të njëjtat nuk është cekur afati i përmbushjes. Tutje ka shtuar se debitori nuk e konteston borxhin që ka ndaj kreditorit mirëpo nuk ka mundësi pagese. I ka propozuar gjykatës që ta prish urdhrin përmbartimor, ndërsa prapësimin ta aprovoj si të bazuar.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke theksuar se propozimit për përmbartim i janë bashkangjitur faturat në origjinal, të pranuar dhe nënshkuara nga ana e debitorit, të njëjtat i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas LPP-së. Tutje ka shtuar se debitori në prapësim e pranon në tërësi borxhin që ka ndaj kreditorit, mirëpo për shkak të pamundësisë së pagesës konsideron se të njëjtit do t'i shkaktohet dëm i pariparueshëm. Sa i përket kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme ka deklaruar se e kundërshton të njëjtën si të pabazuar. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin dhe kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme, ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor si dhe ta obligoj kreditorin që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Me datë 05.07.2024, debitori me anë të parashtrësës, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqet në tërësi nga propozimi për kthim në gjendje të mëparshme dhe prapësimi i paraqitur ndaj urdhrin P.nr.100/2024.

Andaj gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësueses të autorizuar, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.736/24, datë 29.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.